



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

► IDENTIFIKIMI DHE HETIMI I RASTEVE TË FËMIJËVE NË PUNË: SFIDAT E SISTEMIT TË DREJTËSISË

MODUL TRAJNIMI PËR PROKURORË DHE GJYQTARË

Emri i trajnuesit/ve: Prof/ Ass. Dr. Bedri Bahtiri
Prishtinë, 2021

▶ **IDENTIFIKIMI DHE HETIMI I
RASTEVE TË FËMIJËVE NË
PUNË: SFIDAT E SISTEMIT
TË DREJTËSISË**

MODUL TRAJNIMI PËR PROKURORË DHE GJYQTARË

I publikuar nga

Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Autori:

Bedri Bahtiri

© 2021 Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Të gjitha të drejtat rezervohen. Akademia e Drejtësisë së Kosovës nuk pranon kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e pasqyruar dhe nuk është përgjegjës për aktualitetet, korrektësinë, tërësinë apo cilësinë e informacioneve të paraqitura. Prandaj do të refuzohen të gjitha pretendimet rreth dëmit të shkaktuar nga shfrytëzimi i informatave të dhëna, përfshirë edhe informatat të cilat janë të pakompletuara apo të pasakta.

Informacion

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autori dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi / shumëzimi i materialit apo shfrytëzimi i objekteve, siç janë imazhet etj., në publikimet e tjera pa pëlqimin shprehimor nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe autori.

Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt.

Hartimi dhe botimi i këtij moduli është mundësuar nga Projekti: "Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përsheptimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)" i cili financohet nga Departamenti i Punës i SHBA-së dhe menaxhohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

► FALËNDERIME

Ky material është hartuar me mbështetjen e projektit “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përshejtimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” i cili financohet nga Departamenti i Punës i SHBA-së dhe menaxhohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës¹

Materiali është përgatitur që të shërbej si modul trajnimi fillestar për sensibilizimin e sistemit prokurorial dhe gjyqësor mbi problemin e punës së fëmijëve, duke ofruar një pasqyrë të përgjithshme të (a) akteve juridike ndërkombëtare, (b) kuadrit ligjor në Kosovë, (c) situatës së fëmijëve në punë, (c) nivelit të reagimit institucional ndaj punës së fëmijëve, (d) sfidave të sistemit të drejtësisë dhe zbrastësirave në adresimin e problemit të punës së fëmijëve. Bazuar në këtë vlerësim të gjendjes në fund ofrohen edhe rekomandime të përgjithshme për trajtimin e problemit si dhe rekomandime specifike për sektorin e drejtësisë.

Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara, dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara

1 Konceptuar në vitin 2016, projekti MAP16 financohet nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara dhe menaxhohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Projekti synon të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë kritike të nevojshme për të informuar zgjedhjet e politikave dhe për të rritur kapacitetin e partnerëve globalë, rajonalë dhe kombëtarë për t'i mbështetur masat për të zvogëluar punën e fëmijëve dhe punën e detyruar www.ilo.org/map16 Financimi sigurohet nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara nën marrëveshjen bashkëpunuese me numër IL - 30147-16-75 - K - 11. Njëqind për qind e kostove totale të projektit MAP16 financohen me fonde federale, për një total prej 22,400,000 USD.

► PËRMBAJTJA

HYRJE	7
1. KONTEKSTI I PËRGJITHSHËM	11
2. AKTET JURIDIKE NDËRKOMBËTARE DHE STANDARDET PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE	12
3. PËRCAKTIMI KUPTIMOR DHE SPECIFIK I PUNËS SË FËMIJËVE	14
3.1. Definimi i punës së fëmijëve	14
3.2. Shkaqet e punës së fëmijëve	16
4. MBROJTJA E FËMIJËVE NGA FORMAT E RËNDA TË PUNËS SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	18
4.1 Korniza Ligjore	18
4.2. Mbrojtja juridike nga shfrytëzimi i fëmijëve në punë të rënda	19
5. KONTEKSTI NACIONAL I PUNËS SË FËMIJËVE DHE TË DHËNAT STATISTIKORE	23
5.1. Statistikat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për punët e rënda të fëmijëve	23
5.2. Statistikat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për fëmijët e përfshirë në punë të rënda	23
5.3. Të dhënat statistikore të Inspektoratit të Punës për fëmijët e përfshirë në punët e rënda	25
5.4. Të dhënat statistikore të Policisë së Kosovës për fëmijët e përfshirë në punë të rrugës, 2016-2019	25
6. SFIDAT E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË IDENTIFIKIMIN, HETIMIN DHE GJYKIMIN E RASTEVE TË FËMIJËVE NË PUNË	26
PËRFUNDIME	27
REKOMANDIME	28

► Hyrje

Ky modul trajnimi është i përgatitur posaçërisht për gjyqtarë dhe prokurorë. Moduli ofron njohuri themelore mbi punën e fëmijëve, duke e trajtuar nga aspekti i akteve juridike ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm në Kosovë, si dhe statistika konkrete të rasteve të paraqitura, përfshirë edhe identifikimin e problemeve në trajtimin e rasteve të fëmijëve në punë dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për adresimin e tyre.

Ky modul është dizajnuar në atë mënyrë që të gërshetojë shtjellimet teorike dhe të identifikoj problemet lidhur me punën e fëmijëve, me fokus në problemet e zbatimit të legjislacionit në praktikë nga organet e zbatimit të ligjit dhe gjykatat.

Moduli është përgatitur nga një autorë i vetëm, sipas kërkesës së Akademisë së Drejtësisë.

Objektivi trajnues

Sensibilizimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve mbi sfidat aktuale në identifikimin dhe hetimin e rasteve të fëmijëve në punë si dhe mbi hapat e mëtejshëm drejt adresimit të këtyre sfidave.

Metodologjia trajnuese

Trajnimi pritet të zhvillohet në mënyrë interaktive me pjesëmarrësit. Për të mundur këtë, pjesëmarrësit e trajnimit pritet të kenë lexuar modulin para pjesëmarrjes në trajnim, në mënyrë që të kenë marrë informatat mbi problematikën e përmendur këtu.

Gjatë trajnimit, trajneri do të përdor sllajde nga Power Point apo Prezzi, të cilat do t'u shpërndahen pjesëmarrësve në fund të trajnimit.

Në pjesën e fundit të trajnimit, pjesëmarrësit do të shtjellojnë një rast hipotetik të cilin trajneri do ta përgatis për t'u zgjidhur nga pjesëmarrësit.

Pritjet nga trajnimi

Në fund të këtij moduli, nga pjesëmarrësit pritet të thellojnë të kuptuarit mbi:

- format e punës së fëmijëve të sanksionuara me aktet juridike të brendshme dhe ndërkombëtare,
- konceptet kryesore përmbajtësore të akteve juridike ndërkombëtare dhe të brendshme që i referohen punës së fëmijëve;
- problemet praktike në identifikimin, hetimin dhe gjykimin e rasteve të fëmijëve në punë si dhe masat për tejkalimin e tyre.

Mjetet e nevojshme

Gjatë ligjërimit dhe trajnimit, trajneri do të përdor projektoren, Power Pointin apo Prezzin.

Burimet dhe literatura

Burimi themelor për realizimin e këtij moduli është raporti i bashkëngjitur, i cili është përgatitur bazuar në: aktet juridike ndërkombëtare, aktet juridike nacionale dhe statistikat zyrtare të rasteve të trajtuara nga organet administrative, hetuesia dhe gjyqësori. Pasi që ky është punim jo-akademik dhe për ta bërë këtë modul sa më të thjeshtë për përdoruesit, citimet e vazhdueshme janë evituar. Por, e gjithë përmbajtja e raportit të bashkëngjitur është një kombinim dhe përpunim i burimeve të listuara më poshtë:

Aktet juridike ndërkombëtare

- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Pakti Ndërkombëtar Mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Karta Sociale Europiane;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa e ILO-s Nr. 138 për Moshën minimale të pranimin në punë;
- Rekomandimi i ILO-së Nr. 146 për Moshën minimale të pranimin në punë;
- Konventa e ILO-s Nr. 182 për Format më të rënda të punës së fëmijës;
- Rekomandimi i ILO-s Nr. 190 për Format më të rënda të punës së fëmijës;
- SDG (Sustainable Development Goals) - Objektivat e Qëndrueshme Zhvillimore.

Aktet juridike nacionale

- ▶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- ▶ Kodi i Drejtësisë për të mitur në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/18, Tetor 2018);
- ▶ Ligji nr. 03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/01, Dhjetor 2010);
- ▶ Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e fëmijës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 14/17, Korrik 2019);
- ▶ Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës (Gazeta zyrtare Nr. 4/01, Shtator 2006), si dhe Ligji nr.06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 3/17, Janar 2019);
- ▶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2/14 Janar 2019) ka hyrë në fuqi më 14 mars 2019;
- ▶ Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Menjëhershëm të Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve.

Të dhëna statistikore

- ▶ Statistikat janë siguruar në rrugë zyrtare nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- ▶ Statistikat janë siguruar në rrugë zyrtare nga Inspektorati i Punës;
- ▶ Statistikat janë siguruar në rrugë zyrtare nga Policia e Kosovës;
- ▶ UNICEF (2020). 2019-2020 MICS in Kosovo & 2019-2020 MICS with Roma, Ashkali and Egyptian communities in Kosovo: Statistical snapshot <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1936/file/MICS%20Snapshots%20.pdf>
- ▶ Vlerësimi i përpjekjeve të qeverisë për mbrojtjen e vajzave dhe djemve (2017) [http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2018/01/Raporti-shq ip.pdf](http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2018/01/Raporti-shq-ip.pdf).

▶ **IDENTIFIKIMI DHE HETIMI I
RASTEVE TË FËMIJËVE NË
PUNË: SFIDAT E SISTEMIT TË
DREJTËSISË**

(ANALIZË DHE REKOMANDIME)

1. Konteksti i përgjithshëm

Republika e Kosovës, ngjashëm edhe me shtetet tjera në tranzicion, në veçanti në Ballkanin Perëndimor, ka pësuar ndryshime dhe janë bërë transformime të shumta të sistemit të qeverisjes, të cilat janë përcjellë me probleme të vazhdueshme politike dhe socio-ekonomike, përfshirë përhapjen e dukurisë shqetësuese të punëve të rënda të fëmijëve.

Shikuar për nga aspekti i kornizës ligjore, Kosova ka legjislacion shumë të përparuar dhe të përafuar me legjislacionin e shteteve më të zhvilluara të BE-së, e gjithashtu aktet më të rëndësishme juridike ndërkombëtare të fushës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut, e me theks të veçantë edhe të të drejtave të fëmijëve, janë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe zbatohen drejtëpërdrejtë në Kosovë në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së vendit. Megjithatë, duke pasur parasysh një numër të madh të raporteve dhe analizave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në përgjithësi, situata në këtë rrafsh nuk është aspak e mirë dhe me tendencë të përkeqësimit akoma më shumë në këtë periudhë të pandemisë globale COVID-19.

Fatkeqësisht në ditët e sotme në rrugët e qyteteve të Kosovës çdo ditë mund të shohësh me dhjetra fëmijë që shesin cigare dhe gjëra tjera, kërkojnë lëmshë, pastrojnë xhamat e makinave nëpër semafora. Fëmijët angazhohen edhe në ndërtimin e objekteve, në ekonomitë e tyre familjare, në bujqësi, pylltari, eksploatim të pasurive natyrore gjë e cila tregon për jetën e rëndë të kësaj kategorie të fëmijëve. Pra, Kosova nuk ka probleme të theksuara me legjislacionin, por ka probleme me jetësimin e tij në praktikë në të gjitha fushat, përfshirë edhe fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga punët e rënda. Një sistem i mirëfilltë i mbrojtjes së fëmijëve në gjithë kompleksitetin e tij, ende nuk është konsoliduar. Reagimi i institucioneve për raportimin e rasteve të fëmijëve në punë është i mangët, ndërsa shërbimet e mirëfillta për trajtimin e rasteve të fëmijëve në punë të rënda mungojnë apo janë të pamjaftueshme.

Përhapja e kësaj dukurie do ndikoj që në të ardhmen e afërt këta fëmijë të keqtrajtuar dhe të privuar nga e drejta e shkollimit dhe socializimit të jenë barrë për shoqërinë. Prandaj, puna e fëmijëve nuk duhet të konsiderohet vetëm problem i një individi, një familje dhe një komuniteti, por kjo duhet të jetë brengë dhe problem i përgjithshëm shoqëror, për të cilin duhet të kujdesen institucionet shtetërore. Në këtë kontekst, nevojitet edhe vigjilencë e shtuar dhe trajtim adekuat i problemit edhe nga ana e sistemit të drejtësisë.

Kjo analizë e cila shërben edhe si modul trajnimi për zbatuesit e ligjit, në veçanti për sektorin e drejtësisë, do të ishte edhe më e plotë sikur të kishte më shumë statistika specifike të ngritjes së akuzave nga prokuroria dhe më shumë aktgjykime të gjykatave për shpalljen fajtorë të personave që abuzojnë me të drejtat e fëmijëve, pasi që dukuria e puna e fëmijëve është prezente gjithandej.

►► Kosova nuk ka probleme të theksuara me legjislacionin, por ka probleme me jetësimin e tij në praktikë në të gjitha fushat, përfshirë edhe fushën e mbrojtjes së fëmijëve nga punët e rënda.

2. Aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet për mbrojtjen e fëmijëve

Aktet më të rëndësishme juridike ndërkombëtare të cilat rregullojnë fushën e punëve të rënda të fëmijëve, mund të përmbliohen me sa vijon:

- 1 Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. Kjo konventë është pjesë e legjislacionit të brendshëm si pjesë e Kushtetutës së Kosovës, neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], paragrafi (2). Në nenin 4, Konventa ndalon punën pa dëshirë dhe atë të detyrueshme;
- 2 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky pakt është pjesë e legjislacionit të brendshëm si pjesë e Kushtetutës së Kosovës, neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], paragrafi (3). Në nenin 24 thuhet se “Të gjithë fëmijët pa diskriminim race, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, origjinës kombëtare ose sociale, pasurie apo lindjeje, kanë të drejtë të përfitojnë, nga ana familjes së tyre, shoqërisë edhe shtetit, masa mbrojtëse që kërkon moshë e tyre e mitur”;
- 3 Pakti Ndërkombëtar Mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Ky pakt vendos detyrimin për shtetet ratifikuese të marrjes së masave mbrojtëse speciale për fëmijët dhe adoleshentët. Fëmijët dhe adoleshentët duhet të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik dhe shoqëror. Në nenin 10, kërkohet që shtetet të përcaktojnë moshën minimale nën të cilët puna e fëmijëve është e ndaluar;
- 4 Karta Sociale Europiane. Ky dokument vendos veçanërisht këto detyrime për shtete anëtare:
 - ▶ të përcaktohet moshë minimale 15 vjeç, si moshë minimale për punë;
 - ▶ të ndalohet puna e fëmijëve gjatë periudhës së shkollës;
 - ▶ të kufizohet kohezgjatja e punës për personat nën moshën 16 vjeç;
 - ▶ të vendoset që kohëzgjatja e pushimeve të paguara për personat nën 18 vjeç (që është 3 javë);
 - ▶ të ndalohet puna e natës për personat nën 18 vjeç;
 - ▶ të vendoset kontrolli i detyruar tek mjeku për personat nën moshën 18 vjeç, të cilët punësohen në veende pune të përcaktuara nga ligji;
- 5 Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. KDF-ja u adoptua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 20 Nentor 1989. Shtetet palë të kësaj konvente njohin të drejtën e arsimit bazë, të detyrueshëm dhe pa pagesë për të gjithë fëmijët, si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë shfrytëzimi;

- 6 Konventa e ILO-s Nr. 138, Për moshën minimale të pranimit në punë. Shtetet që ratifikojnë Konventën Nr. 138 të ILO-s duhet të marrin një sërë masash për të siguruar ndalimin e punës së fëmijëve dhe të rrisin progresivisht moshën minimale për punësimin e fëmijëve në përshtatje me zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës;
- 7 Rekomandimi i ILO-së Nr. 146 për Moshën minimale të pranimit në punë, i vitit 1973, gjithashtu është me rëndësi për mbrojtjen e fëmijëve nga angazhiminë punët e rënda;
- 8 Konventa 182 e ILO-s (1999) për format më të rënda të punës së fëmijës. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “format më të rënda të punës së fëmijës” të parapara në nenin 3 përfshijnë:
- a. Të gjitha format e skllavërisë apo praktikave të ngjashme me të, siç janë shitja dhe trafikimi i fëmijëve, lidhja nga borxhi dhe puna e detyruar dhe e sforcuar, përfshirë këtu rekrutimin me forcë apo të detyruar të fëmijëve për përdorim në konfliktet e armatosura;
 - b. Përdorimin, prokurimin dhe ofrimin e fëmijës për prostitucion, për prodhime pornografike apo për shfaqje pornografike;
 - c. Përdorimin, prokurimin dhe ofrimin e fëmijës për aktivitete të jashtëligjshme, në mënyrë të veçantë për prodhimin dhe trafikimin e drogave sipas përkufizimeve që i bëhen atyre në traktate përkatëse ndërkombëtare;
 - d. Për punë, të cilat nga natyra dhe kushtet që kryhen, përmbajnë rrezikun e dëmeve për shëndetin, sigurinë dhe moralin e fëmijëve.
- Gjithashtu kjo Konventë, në nenin 4 flet për tipet e punëve që referohen në nenin 3 (d) të cilat duhet të përcaktohen nga ligjet dhe rregulloret kombëtare ose nga autoritete kompetente, pasi janë konsultuar me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve të interesuara, duhet të kihet parasysh standardet ndërkombëtare përkatëse, në mënyrë të veçantë paragrafet 3 dhe 4 të Rekomandimit 190 për Format më të Rënda të Punës së Fëmijës, 1999.
- 9 Rekomandimi i ILO-s Nr. 190 për Format më të rënda të punës së fëmijës, ku me rëndësi janë Rekomandimet dhe udhëzimet për qeveritë (dhe partnerët socialë) për punën që mund të jetë e rrezikshme për fëmijët dhe mund të përfshihet në një listë kombëtare për Format e Rrezikshme të Punës së Fëmijëve;
- 10 SDG (Sustainable Development Goals) - Objektivat e Qëndrueshme Zhvillimore janë një koleksion prej 17 qëllimesh globale të ndërlidhura dhe të dizajnuara për të qenë një “plan për të arritur një të ardhme më të mirë dhe më të qëndrueshme për të gjithë”. SDG-të u vendosën në 2015 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe synojnë të arrihen deri në vitin 2030. Ato përfshihen në një Rezolutë të KB të quajtur Agjenda e 2030. Kosova, edhe pse nuk është palë nënshkruese e Agjendës 2030 dhe OQZH-ve, ka marrë vendim për t’ju bashkuar përpjekjeve të përbashkëta për arritjen e tyre. Një gjë e tillë është bërë në mënyrë vullnetare, përmes adoptimit të një rezolute parlamentare të Kuvendit të Kosovës për miratimin e OQZH në Janar të vitit 2018.

3. Përcaktimi kuptimor dhe specifik i punës së fëmijëve

3.1. Definimi i punës së fëmijëve

Çfarë është puna e fëmijëve?

Termi “punë e fëmijëve” shpeshherë përkufizohet si punë që privon fëmijërinë e fëmijës, potencialin dhe dinjitetin e tij dhe që është e dëmshme për zhvillimin fizik dhe mendor. I referohet punës që:

- mendërisht, psikologjikisht, shoqërisht dhe moralisht është e dëmshme dhe e rrezikshme për fëmijët; dhe
- ndërhyt në shkollimin e fëmijëve duke: (a) i privuar ata nga mundësia për të ndjekur shkollën, (b) i detyruar ata të lënë shkollën para kohe, ose (c) i detyruar ata të ndjekin shkollën në kushte shumë të vështira.

Se a mund të quhen format e veçanta të “punës” si “punë e fëmijëve” varet nga mosha e fëmijës, lloji dhe orari i punës që ai bën, kushtet në të cilat kjo punë kryhet dhe synimet e vëna nga secili vend.

Cilat janë format më të rënda të punës së fëmijëve?

Përderisa puna e fëmijëve merr shumë forma të ndryshme, prioritet është të eliminohen pa vonesë format më të rënda (këqija) të punës së fëmijëve, siç përcaktohet në nenin 3 të Konventës së ONP-së për format më të rënda të punës së fëmijëve nr. 182 (1999). Konform kwsaj Konvente, puna e detyruar, rekrutimi i fëmijëve për përdorim në konflikt të armatosur, trafikimi i fëmijëve, përdorimi i fëmijëve për prostitucion dhe pornografi, dhe aktivitetet e paligjshme në Kosovë janë të ndaluara nga Kodi Penal.

Kategoria e katërt (d) cilësohet si punë e rrezikshme e fëmijëve dhe i referohet punës që ka gjasa të rezultojë në vdekjen e fëmijës, lëndimin (shpeshherë për gjithë jetën) ose sëmurjen (shpeshherë për gjithë jetën) për shkak të natyrës

së punës ose si pasojë e vendit jo të sigurt të punës, standardeve të ulëta të sigurisë dhe shëndetit dhe kushteve dhe rregullimeve të punës. Sipas paragrafëve 3 dhe 4 të Rekomandimit të ONP-së 190 (1999), në përcaktimin e llojeve të punës të përmendura në nenin 3(d) të Konventës, dhe në identifikimin e vendit ku ato ekzistojnë, vëmendje duhet t’i kushtohet, ndër të tjera: (a) punës dhe veprimtarive që ekspozojnë fëmijët ndaj abuzimit fizik, psikologjik apo seksual; (b) punës nën tokë, nën ujë ose në lartësi të rrezikshme ose në hapësira të kufizuara; (c) punës me makineri, me pajisje dhe me vegla të rrezikshme ose asaj që përfshin përpunimin ose transportin me dorë të ngarkesave të rënda; (d) punës në një mjedis të pashëndetshëm, i cili mund të ekspozojë për shembull, fëmijët ndaj lëndëve, faktorëve ose proceseve të rrezikshme ose ndaj temperaturave, niveleve të zhurmës ose dridhjeve të rrezikshme, që dëmtojnë shëndetin e tyre; (e) punës në kushte veçanërisht të vështira, siç është puna me orë të zgjatura ose gjatë natës ose puna që nuk lejon kthimin në shtëpi çdo ditë, ose puna në të cilën fëmija është i mbyllur në mënyrë të paarsyeshme në ambientet e punëdhënësit.

Sa i përket kësaj kategorie, versioni i parë i listës së punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë është përgatitur me mbështetjen e ONP-së gjatë periudhës 2005-2007, dhe ka hyrë në fuqi ligjërisht si Udhëzim Administrativ i Qeverisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rrezikshme për Fëmijë në Kosovë (UA 17/2008). Udhëzimi Administrativ rendit (a) sektorët e rrezikshëm dhe (b) aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që duhet të ndalohen si çështje parësore. Në vitin 2013, UA 17/2008 u zëvendësua me UA 05/2013, duke përditësuar listën e punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë.

Si përkufizohet puna e lehtë e fëmijëve?

Jo të gjitha punët që kryejnë fëmijët dhe adoleshentët duhen të klasifikohen si punë e fëmijëve dhe duhet të tentohen të eliminohen. Pjesëmarrja e fëmijëve ose e adoleshentëve në punë që nuk ndikon në shëndetin dhe zhvillimin e tyre personal, ose që nuk ndërhyjnë në shkollimin e tyre, në përgjithësi konsiderohet si pozitive. Kjo përfshin aktivitete të tilla si të ndihmshme prindërit rreth shtëpisë, të ndihmshme në një biznes familjar ose të fitosh para jashtë orëve të mësimin dhe gjatë pushimeve shkollore. Për t'u cilësuar si punë e lejuar për fëmijë, e gjithë natyra dhe kushtet e detyrave të lartpërmendura duhet të mos paraqesin rrezik dhe të jenë të përshtatshme për moshën dhe aftësitë psikofizike të një fëmije dhe nuk duhet të pengojnë shkollimin e fëmijës. Këto lloje aktivitete kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve dhe në mirëqenien e familjeve të tyre dhe gjithashtu u sigurojnë atyre aftësi dhe përvojë, si dhe i ndihmojnë në përgatitjen e tyre për të qenë anëtarë produktivë të shoqërisë gjatë jetës së tyre si të rritur.

Kështu, puna e lejuar për fëmijët mbi moshën minimale për llojin e punës në fjalë konsiderohet si pjesëmarrje në aktivitete ekonomike jo të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, dhe veçanërisht që nuk e pengon atë të ndjekë shkollimin dhe të luaj.

Punë të lejuara të fëmijëve janë edhe ato të cilat me vendim të gjykatës, në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të mitur në Kosovë, nëse fëmijët janë kryes të veprave penale, gjykatave u njihet e drejta e shqiptimit të masave të diversitetit dhe dënimeve alternative siç është edhe puna në dobi të përgjithshme. Por kjo masë duhet të jetë në pajtim me aftësitë psiko fizike të fëmijës, punë që nuk e pengojnë në vijimin e shkollës dhe aktiviteteve tjera zbatuese dhe edukative, të cilat vlerësohet se janë në interesin më të lartë të fëmijës. Punë të tilla zakonisht janë

punët në bibliotekë, puna në palestër sportive e të ngjashme. Në të gjitha rastet kur gjykata shqipton masat e këtilla, atëherë duhet të duhet specifikisht të përcaktoj në vendimin e saj se ndalohen punët e rënda të fëmijëve sipas listës së formave të rënda të punës të përcaktuara me aktet juridike ndërkombëtare si dhe të inkorporuara edhe në Udhëzimin Administrativ të përmendur në këtë modul.

► Punë të lejuara të fëmijëve janë edhe ato të cilat me vendim të gjykatës, në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të mitur në Kosovë, nëse fëmijët janë kryes të veprave penale, gjykatave u njihet e drejta e shqiptimit të masave të diversitetit dhe dënimeve alternative siç është edhe puna në dobi të përgjithshme.

3.2. Shkaqet e punës së fëmijëve

Natyra e keqpërdorimit të punës së fëmijës është e kushtëzuar nga mosha e fëmijës, nga gjendja e tij shëndetësore, rrethanat ekonomike në shtet, shkalla e zhvillimit të teknologjisë dhe shkalla e vetëdijes së përgjithshme për nevojën e kujdesit për fëmijën. Prandinë e faktorëve më të mëdhenj të rreziqeve i gjejmë në vendet e varfëra dhe në ato të cilat vlerësohen si vende në krizë (nga arsyet politike apo ekonomike). Në veçanti të prekur konsiderohen shtresat më të varfëra, duke përfshirë fëmijët e imigrantëve, fëmijët të cilët jetojnë në rrugë, fëmijët pjesëtarë të grupeve pakicë, fëmijët refugjatë, etj.

Varfëria është shkak dhe pasojë e punës së fëmijëve. Varfëria dhe puna e fëmijëve janë përbërësit kryesorë të një "ekuilibri të ulët ekonomik" në familje, komunitet dhe nivel vendi. Familjet e varfra i vendosin fëmijët e tyre të punojnë për t'i plotësuar të ardhurat e pakta të familjes së tyre. Prandaj, puna e fëmijëve është një pikë e rëndësishme hyrëse për uljen e varfërisë dhe për masat e mbrojtjes sociale, madje edhe në mesin e më të varfërve, për të cilët zgjidhjet e qëndrueshme janë të vështira për t'u identifikuar (përtej ndihmës së drejtpërdrejtë sociale).

Përveç varfërisë, shumë faktorë të tjerë kontribuojnë në punën e fëmijëve:

- **Qëndrimi mbështetës ndaj punës së fëmijëve – Prindërit** (por dhe mësuesit dhe shoqëria e përgjithshme) mund të shikojnë punën e fëmijëve si pjesë të edukimit të fëmijës, veçanërisht në rajone ku arsimit nuk përkthehet në përfitime ekonomike për të rinjtë. Prindërit gjithashtu mund të mbështesin punën e fëmijëve si mënyrë për t'i mbajtur fëmijët e tyre të sigurt, në rajone ku disa fëmijë diskriminohen dhe i nënshtrohen dhunës në shkollë.
- **Mjedisi i çrregulluar familjar** – Familjet me një prind, sëmundja ose paaftësia e fituesit të bukës, varësia e tij/saj ndaj alkoolit ose drogës, mungesa e aftësive të prindërve, abuzimi dhe dhuna, e vënë fëmijën në rrezik më të madh për përfshirje në punën e fëmijëve, qoftë për shkak se fëmija do të detyrohet që të punojë nga prindërit e tij, ose sepse ai do të largohet nga shtëpia për të jetuar jetën e tij (p.sh.: fëmijët në rrugë).
- **Mungesa e qasjes në arsim** – kur kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të arsimit (përfshirë koston e rrobave, librave, materialeve) janë shumë të larta që prindërit t'u lejojnë fëmijëve t'i ndjekin mësimet dhe/ose kur shkollat janë gjeografikisht të largëta.
- **Diskriminimi** – disa minoritete apo grupe tjera të marginalizuara mund të kenë qasje më të vogël në arsim ose tregun e punës dhe mund të pritët që ato të kryejnë detyra specifike përderisa janë ende fëmijë. Një tjetër bazë e përbashkët për diskriminimin është gjinia. Ndarja me bazë gjinore e punës mund t'i detyrojë gratë dhe burrat t'i kufizojnë perspektivat e punës së tyre në një varg të caktuar që nuk ka nevojë për arsim por praktika "në punë" që në moshë të re. Vajzat gjithashtu mund të detyrohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të kryejnë detyra që nuk kompensohen.
- **Kërkesa:** kosto më të ulëta dhe aftësi gjoja të pazëvendësueshme – janë dy arsye kryesore që punëdhënësit të punësojnë fëmijë. Fëmijët punojnë për paga më të lira, janë më të lehtë për t'u manipuluar dhe mund të kryejnë veprimtari që të rriturit nuk mund t'i bëjnë me të njëjtën kosto. Fëmijët gjithashtu nuk kanë dijeni për të drejtat e tyre dhe ka më pak të ngjarë të ankohen ose të revoltohen.
- **Kërkesa:** Kërkesat e klientit – Për një lloj shfrytëzimi të caktuar (si shfrytëzimi seksual i fëmijëve), klientët mund të preferojnë t'i shfrytëzojnë fëmijët në vend të të rriturve.
- **Përhapja e sektorit informal dhe mungesa e zbatimit të ligjit** – Mungesa e kontratave dhe negociimit kolektiv në sektorin informal e vështirësojnë mbrojtjen e fëmijëve nga kushtet abuzive të punës dhe identifikimin e fëmijëve në punë. Një nga anët negative të globalizimit është se ka kontribuar në zgjerimin e marrëveshjeve nën-kontraktuese, ku kryesisht shfrytëzohet puna e

fëmijëve. Përkeqësimi i sundimit të ligjit ka lejuar që ekonomia në hije të rritet dhe korrupsioni të pushtojë shumë aspekte të jetës së njerëzve. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në (a) incidencën e formave më të rënda të punës së fëmijëve në lidhje me aktivitetet kriminale (veprimtari të paligjshme, trafikim dhe prostitucion - kur kriminalizohet), dhe (b) zbatimin e ligjeve dhe politikave të lidhura me punën e fëmijëve.

- Ekziston edhe një «**vakum i përkohshëm i vlerave**», në të cilin presionet konkurruese nga konsumatorizmi perëndimor kundrejt traditave dhe privimi ekstrem personal ka dëmtuar bazën e vlerës së familjes dhe komunitetit dhe për rrjedhojë ka rritur cenueshmërinë e fëmijëve. Për shkak të mungesës së mbikëqyrjes dhe kujdesit të duhur, rrugët bëhen zona kryesore për socializimin e fëmijëve.

4. Mbrojtja e fëmijëve nga format e rënda të punës sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës

4.1 Korniza Ligjore

Korniza ligjore mbi punën e fëmijëve në Kosovë është e gjerë dhe krijon mundësi të mirë për ofrimin e mbrojtjes. Kjo kornizë ligjore mund të përmbledhet me sa vijon:

- **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**, përmban dispozita në lidhje me të drejtën e fëmijëve për mbrojtje dhe përkujdesje të nevojshme për mirëqenien e tyre, përfshirë të drejtën për mbrojtje nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi;
- **Ligji i punës (Nr. 03/L -212)**, përcakton moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare si moshë minimale për punësim. Marrëdhënia e punës me një person ndërmjet moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjeçare mund të vendoset për punë të lehta të cilat nuk paraqesin rrezik për shëndetin dhe zhvillimin e tij/saj;
- **Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, si dhe Ligji nr.06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës**, me të cilin rregullohen çështjet familjare në përgjithësi, përfshirë edhe të drejtën prindore dhe detyrimin për ushtrimin e saj, duke përfshirë përgjegjësitë për familjen në përgjithësi dhe mbrojtjen e fëmijëve në veçanti;
- **Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve**, shprehimisht parandalon të gjitha format të cilat cenojnë mirërritjen e fëmijëve dhe parasheh të gjithë kuadrin institucional për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik nga punët e rënda;
- **Kodi Penal (Ligji Nr. 03/L-002)**, përcakton veprat penale të kryera ndaj një fëmije për procesin gjyqësor ndaj të rriturve përfshirë mospërbushjen e obligimeve familjare, mundësimin e prostitucionit, keqtrajtimin e fëmijëve në pornografi, shfrytëzimin e fëmijëve në konflikte të armatosura, shfrytëzimin e fëmijëve për aktivitete joligjore, vendosjen e kushteve të skllavërisë apo kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe punën e detyruar;
- **Udhëzimi Administrativ për Parandalimin dhe Ndalimin e Menjëhershëm të Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve (Nr. 05/2013)**, përfshinë sektorët e rrezikshëm dhe aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që të ndalohen si çështje me prioritet në Kosovë.

Shikuar nga të gjitha këto akte juridike të brendshme në Kosovë si dhe shikuar nga pikëpamja e statusit të fëmijës në familje dhe në shoqëri, duhet medoemos të kemi zbatim më të madh në praktikë të gjithë kësaj kornize kushtetuese, ligjore dhe nënligjore. Kjo vlen edhe më tepër kur Konventat e shumta dhe aktet juridike ndërkombëtare, sidomos të fushës së të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve, janë të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë në bazë të nenit 22 të Kushtetutës.

Çështja e mbrojtjes së fëmijëve bazohet në përcaktimin se mbrojtja e fëmijës apo mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është parimi bazik i vlerave njerëzore dhe të dinjitetit të personalitetit, që si kërkesë univverzale dhe e arritur civile i përket çdo qenje njerëzore, ndërsa kur bëhet fjalë për fëmijët, shprehet si sigurim i kushteve për fëmijëri të lumtur.

4.2. Mbrojtja juridike nga shfrytëzimi i fëmijëve në punë të rënda

Mosha. Gati të gjitha shtetet e botës i lejojnë fëmijës së moshës së caktuar themelimin e marrëdhënies së punës. Mosha e cila merret si kufiri i poshtëm i aftësisë së punës (14, 15 apo 16 vjet) si rregull përputhet me përfundimin e shkollimit themelor apo të ndonjë forme tjetër të aftësisë profesionale të fëmijës. Përveç në kontekstin e arsimit, mosha si kusht për themelimin të marrëdhënies së punës është në lidhje edhe me aftësitë zhvilluese, përkatësisht me nivelin e arritur të zhvillimit psikofizik dhe me aftësitë e zhvillimit, përkatësisht të nivelit të arritur të zhvillimit psiko-fizik të fëmijës i cili i ka mbushur vitet e caktuara të jetës, ndërsa parashihen, para së gjithash, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të papengueshëm të fëmijës.

Ligji për Punën i Republikës së Kosovës parasheh se marrëdhënia e punës mund të themelohet me të miturin i cili i ka së paku 15 vjet jetë dhe i plotëson kushtet e tjera për angazhim në punët e caktuara. Fëmijët deri në tetmbëdhjetë (18) vjet mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor .

Aftësia shëndetësore. Plotësimi i kushteve në pikëpamje të aftësisë për kryerjen e punëve të caktuara për të cilat themelohet marrëdhënia e punës vlerësohet, përkatësisht verifikimin se ato punë nuk do të ndikojnë dëmshëm në shëndetin e të miturit e jep organi kompetent i shëndetësisë. Përjashtimisht nga rregulla se shpenzimet e kontrollit mjekësor me qëllim të themelimit të marrëdhënies së punës i bartë kandidati për punësim, shpenzimet e kontrollit mjekësor për të miturin i cili themelon marrëdhënien e punës i bartë Ministria kompetente për punësimin, në evidencën e të cilës gjendet i mituri si person i pa punë.²

Me Ligjin për punë të Republikës së Kosovës në nenin 45 është përcaktuar se në punët në të cilat ekziston rreziku i rritur nga lëndimet apo rreziku nga sëmundjet profesionale apo të sëmundjeve tjera mund të punoj vetëm i punësuar i cili, krahas kushteve të veçanta që përcaktohen me rregulloren përkatëse për organizimin dhe sistematizimin e punëve, i plotëson edhe kushtet për punë në pikëpamje të gjendjes shëndetësore, aftësitë psiko-fizike dhe të moshës jetësore. Punëdhënësi është i obliguar që të adoptojë masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të të rinjve, duke specifikuar rreziqet në procesin e punës, ndërsa këto masa duhet t'i zbatojnë në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë për vendet e punës së të rinjve. Gjithashtu, për mbrojtjen e plotë të të rinjve në punë, punëdhënësi duhet ta bëjë vlerësimin paraprak të rrezikshmërisë për vendet e punës, para se i riu t'ia fillojë punës³.

Ligji i punës, gjithashtu ka përcaktuar punët e rrezikshme në të cilat i punësuarin nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punojë. Punë të rrezikshme për punësim nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet sipas paragrafit 5 të nenit 45 të Ligjit të Punës konsiderohen punët:

- në nëntokë, nën ujë, në lartësi të rrezikshme apo në vende të mbyllura;
- me makineri të rrezikshme, në pajisjet dhe veglat, të cilat duhen shfrytëzuar, dhe në transportimin e ngarkesave të rënda;
- në mjedis jo të shëndoshë, i cili për shembull i ekspozon të rinjtë në substancat e rrezikshme, faktorëve ose proceseve, temperaturave, zhurmave dhe dridhjeve që dëmtojnë shëndetin e tyre;
- nën kushte posaçërisht të vështira siç është puna me orar të gjatë, apo në rrethana të caktuara gjatë natës, puna në mjedis të mbyllur.

² Neni 7 paragrafi 2 i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/01 Dhjetor 2010).

³ Neni 45 paragrafi 2, 3 dhe 4 i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/01 Dhjetor 2010).

Sipas UA 05/2013, sektorët me rrezikshmëri të lartë dhe të ndaluar për fëmijët nën moshën 18 vjeçare janë si vijon:

- Sektori i bujqësisë dhe pylltarisë
- Puna në rrugë
- Puna në ndërtimtari
- Puna në deponi të mbeturinave
- Puna në eksploatimin e pasurive natyrore.

Për secilin prej sektorëve të lartpërmendur, UA 05/2013 përcakton aktivitetet specifike që nuk guxon të ushtrohen nga fëmijët nën moshën 18 vjeçare.

Lidhur me këtë listë të llojeve të punëve të rrezikshme, me ligj përcaktohet edhe detyrimi i shqyrtimit për çdo vit, nga organi përkatës si përfaqësues të tyre të cilët janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministrinë e tjera përkatëse të Qeverisë, organizatat e punëdhënësve dhe organizatat të të punësuarve (sindikatat)⁴.

Koha e punës. Në pajtim me Ligjin për punën, koha e punës e të miturit të punësuar nuk mund të përcaktohet në kohëzgjatje më të gjatë se 36 orë në javë as më gjatë se 8 orë në ditë⁵. I mituri nuk mund të punojë jashtë orarit të punës dhe as natën. I punësuar i mitur i cili punon së paku 4 orë e 30 minuta ka të drejtë në pushim ditor në kohëzgjatje prej 30 minutash. Me UA 05/2013, puna e natës përfshinë periudhën ndërmjet orës 20:00 dhe 6:00.

Ligji për mbrojtjen e fëmijëve - ka rregulluar shumë çështje që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve dhe të drejtat për punë. Lidhur me parimet e punës së fëmijës, Ligji në fjalë përcakton se fëmija ka të drejtë për punë të denjë, ndërsa puna e lejuar e fëmijës nuk duhet të rrezikojë asnjë nga të drejtat e përcaktuara në këtë ligj, duke përfshirë të drejtën për mirëqenie fizike dhe mendore, të drejtën për arsimim, shëndet dhe të drejtën për kohë të lirë dhe lojë⁶. Dispozitat e neneve 49, 50 dhe 51 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 49 zbatohen edhe për agjencitë private të punësimit, nga se edhe sektori privat i punësimit është përgjegjës sikurse personat juridik publik për çdo shkelje të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve⁷.

Meqenëse angazhimi i fëmijëve në punët e shtëpisë nuk është i rregulluar në Kosovë, përkufizimet e Treguesit 2 për matjen e punës së fëmijëve me qëllim të raportimit për Objektivat e Qëndrueshme Zhvillimore (OQZh-të), mund të aplikohen (krahas UA 05/2013) për identifikimin e fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve, vlerësimin e rrezikut, si dhe në raportimin për OZHQ-të. Treguesi i parë bazohet në kufirin e prodhimit të vendosur nga Sistemi i Kombeve të Bashkuara për Llogaritë Kombëtare (SNA) dhe i dyti bazohet në kufirin e përgjithshëm të prodhimit. Treguesi 1 kufizon kornizën e referencës për aktivitetin ekonomik, ndërsa Treguesi 2 e shtrin atë për të përfshirë si aktivitetin ekonomik ashtu edhe shërbimet shtëpiake të papaguara, domethënë prodhimin e shërbimeve shtëpiake dhe personale nga një anëtar i familjes për konsum brenda familjes së tyre, që zakonisht quhen «punët e shtëpisë».

4 Neni 45 paragrafi 6 dhe 7, i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/01 Dhjetor 2010).

5 Neni 31 paragrafi 2 i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/01 Dhjetor 2010).

6 Neni 49 i Ligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 14/17 Korrik 2019).

7 Neni 1 i Konventës 181 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Treguesi 2: Përçindja dhe numri i fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të angazhuar në aktivitete ekonomike dhe punët e shtëpisë në ose mbi pragjet e orarit specifik për moshën (mbi kufirin e prodhimit të përgjithshëm):

- ▶ Puna e fëmijëve për grupmoshën 5 deri në 11 vjeç: fëmijët që punojnë së paku 1 orë në javë në aktivitet ekonomik dhe/ose janë të përfshirë në shërbime shtëpiake të papaguara për më shumë se 21 orë në javë;
- ▶ Puna e fëmijëve për grupmoshën 12 deri në 14 vjeç: fëmijë që punojnë për të paktën 14 orë në javë në aktivitet ekonomik dhe/ose janë të përfshirë në shërbime shtëpiake të papaguara për më shumë se 21 orë në javë;
- ▶ Puna e fëmijëve për grupmoshën 15 deri në 17 vjeç: fëmijët që punojnë për më shumë se 43 orë në javë në aktivitet ekonomik.

Pëlqimi i prindërve. Themelimi i marrëdhënies së punës me të miturin kushtëzohet me pëlqimin me shkrim të prindërve, përkatësisht të adoptuesit apo të kujdestarit. Këtë çështje e rregullon Ligji për Familjen i Kosovës, i cili në nenin 136 paragrafi 2 përcakton se fëmija që ka mbushur 15 vjet, me pëlqim të përfaqësuesit të tij ligjor në mënyrë të pavarur mund të themelojë marrëdhënien e punës dhe të disponojë me të ardhurat e veta personale dhe me pasurinë që e ka fituar me punën e vet, por është i detyruar që nga këto të hyra të kontribuojë për ushqimin, edukimin dhe arsimimin e vet.

Në pajtim me këtë, prindi, përkatësisht personi tjetër i cili ka autorizime prindore ndaj të miturit, duhet të vlerësoj nëse puna e tillë do të rrezikonte shëndetin e të miturit, nëse do të ishte i dëmshëm për te moralisht apo nëse do ta pamundësonte që të vijoj shkollimin ose shkollimi i tij dukshëm do të vështirësohej. Po qe se prindi, edhe përkundër kushteve të rrezikshme të punës, ka dhënë pëlqimin për themelimin e marrëdhënies së punës me fëmijën, punëdhënësi nuk do të duhej të lidhte kontratën e tillë për punën, sepse me këtë do të shkelte normën imperative të nenit 136 paragrafi 2 i Ligjit për Familjen të Kosovës. Kjo shkelje në pajtim me nenin 92 të Ligjit të punës, ka karakter të kundërvajtjes për të cilën personit fizik dhe juridik që nuk i përfill dispozitat e këtij ligji, në procedurë ligjore ka mundësi t'i shqiptohet gjoba prej njëqind (100) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, ndërsa nëse shkelja është bërë kundër të punësuarit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, punëdhënësi apo personit tjetër përgjegjës, do të gjohet me gjobë në lartësinë e dyfishit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Për prindërit, sanksionin e parasheh legjislacioni familjar. Kështu, sipas nenit 149 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen është paraparë se prindërit të cilët e keqpërdorin ushtrimin e të drejtës prindërore ose në mënyrë serioze e neglizhojnë ushtrimin e të drejtës prindërore, privohen nga kujdesi prindëror. Prindi mund të privohet nga kujdesi për të gjithë fëmijët, e nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e posaçme, ata privohen nga kujdesi vetëm ndaj njërit fëmijë. Procedurën e privimit nga kujdesi prindor mund të inicohet nga prindi tjetër, organi i kujdestarisë apo gjykata, ndërsa vendimin mbi privimin e prindërve nga kujdesi prindëror e merr gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore pasi të ketë marrë mendimin nga Organi i Kujdestarisë dhe pasi të ketë hetuar të gjitha rrethanat relevante lidhur me rastin individual⁸. Ligji për familjen lejon edhe rikthimin e kujdesit prindëror, nëse arsyet që kanë shkaktuar privimin e kujdesit prindëror pushojnë të ekzistojnë, prindit ose prindërve me vendim të gjykatës u kthehet kujdesi prindëror. Edhe në rastin e rikthimit të kujdesit prindëror kërkesa për rikthim mund të parashtrohet nga prindi dhe organi i kujdestarisë, ndërsa në kontestet martesore dhe kontestet lidhur me marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve, gjykata që merret me këto çështje mundet ex officio të merr vendim për rikthimin e kujdesit prindëror, nëse konkludon se janë plotësuar kushtet për këtë⁹.

⁸ Neni 149 dhe 150 i Ligjit për Familjen i Kosovës (Gazeta zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Nr. 4/01 Shtator 2006).

⁹ Neni 151 i Ligjit për Familjen i Kosovës (Gazeta zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Nr. 4/01 Shtator 2006).

Pra, sipas Ligjit për Punën, marrëdhënia e punës me të miturin nuk do të mund të themelohej edhe nëse lejohet nga prindërit. Sa i përket Ligjit për Familjen, dërgimi apo inkurajimi i fëmijut në punë e cila është e ndaluar me ligj, do të kishte për pasojë privimin e plotë të prindit nga e drejta prinëdore. Pashmënjtë e njëjtë e ka edhe sjellja e prindit i cili e shfrytëzon fëmijën duke e nxitë për punë të tepruar, ose për punë e cila rrezikon moralin, shëndetin apo arsimimin e fëmijës. Në të njëjtin rrafsh është edhe inkurajimi i fëmijës në kryerjen e veprave penale, si dhe çdo trajtim i keq fizik, seksual apo emocional i fëmijës.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës¹⁰ mundësimin ose detyrimin në prostitucion e ka përcaktuar si vepër penale, për të cilën, në nenin 234 paragrafi 4 ka paraparë se kur vepra kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në njëzetë (20) vjet. Me nenin 237 është paraparë si vepër penale ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, ndërsa dënimi është me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet. Gjithashtu Kodi Penal për veprën penale keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi sipas nenit 232 paragrafi 1, për kryesit që prodhojnë pornografi me fëmijët ose përdorin apo përfshinë fëmijën për krijimin ose për prodhimin e shfaqjeve të gjalla, dënohen me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Për skllavërinë dhe punën e detyruar, përkatësisht në shkelje të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht për mbajtje, ruajtje, vendosje, blerje apo shitje të një personi tjetër në skllavëri, në kushte të ngjashme me skllavërinë, robëri ose në punë të detyruar, që përfshinë por nuk kufizohet në mbajtjen e personit në pronësi, mohimin e fryteve të punës së tij, shtrëngimin e personit për të punuar ose mohimin e lirisë së një personi për të ndryshuar statusin e tij apo të kushteve të punës, nëse vepra penale kryhet ndaj fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, ndërkaq nëse kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin e detyrës së tij, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet për veprën nga paragrafët 1.-3.; ose me burgim prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet për veprën nga paragrafi 4. i këtij neni.

¹⁰ 24s Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 2/14 Janar 2019) ka hyrë në fuqi më 14 mars 2019

5. Konteksti nacional i punës së fëmijëve dhe të dhënat statistikore

5.1. Statistikat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për punët e rënda të fëmijëve

Të dhënat e fundit të Hulumtimit të Treguesve të Shumëfishtë i cili realizohet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës me mbështetje të UNICEF¹¹ tregojnë se 5% e fëmijëve të moshës 5-17 vjecare në popullatën e përgjithshme janë të përfshirë në punë, ndërsa në mesin e komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptian kjo shifër shkon në 7%. Përfshirja në forma të rrezikshme të punës rezulton të jetë 6% në mesin e popullatës së përgjithshme dhe 7% në mesin e komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptian.

5.2. Statistikat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për fëmijët e përfshirë në punë të rënda¹².

Përkundër të dhënave të ASK-së, të dhënat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare (DPSF) tregojnë se në vitin 2016, shteti ka identifikuar, në nivel vendi, vetëm 62 raste të fëmijëve të përfshirë në punë, ndërsa gjatë vitit 2017 gjithësej 42 fëmijë në punë të rënda. Numri i rasteve të identifikuara në vitin 2018 është 250, ndërsa në vitin 2019 është 129 raste.




Figura 1: Përqindja e fëmijëve të identifikuar në punë të rënda sipas sektorëve gjatë vitit 2017

¹¹ 2019-2020 MICS in Kosovo & 2019-2020 MICS with Roma, Ashkali and Egyptian communities in Kosovo: Statistical snapshot <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1936/file/MICS%20Snapshots%20.pdf>

¹² Statistikat janë siguruar në rrugë zyrtare nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.




Figura 2: Përqindja e fëmijëve të identifikuar në punë të rënda sipas sektorëve gjatë vitit 2018




Figura 3: Përqindja e fëmijëve të identifikuar në punë të rënda sipas sektorëve gjatë vitit 2019

Qendrat për Punë Sociale si institucion përgjegjës për ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale për kategoritë në gjendje dhe në nevojë sociale, për këta fëmijë të identifikuar në kategorinë e lëmoshë kërkuesve kanë ofruar këto shërbime sociale:

- ▶ Shërbime shëndetësore;
- ▶ Këshilla psiko sociale;
- ▶ Në skemën e asistencës sociale;
- ▶ Akomodim;
- ▶ Shërbime këshillimi dhe vetëdijesimi.

5.3. Të dhënat statistikore të Inspektoratit të Punës për fëmijët e përfshirë në punët e rënda

Bazuar në shënimet nga baza e të dhënave të dërguara nga Inspektorati i Punës, rezulton se aktualisht janë 5 raste të punëve të rënda të fëmijëve të cilat i ka identifikuar ky organ.

5.4. Të dhënat statistikore të Policisë së Kosovës për fëmijët e përfshirë në punë të rrugës, 2016-2019

- ▶ **Viti 2016** - janë identifikuar 215 fëmijë në situatë rruge;
- ▶ **Viti 2017** - janë identifikuar 195 fëmijë në situatë rruge;
- ▶ **Viti 2018** - janë identifikuar 205 fëmijë në situatë rruge;
- ▶ **Viti 2019** - janë identifikuar 124 fëmijë në situatë rruge;
- ▶ **Janar - Shtator 2020** janë identifikuar 84 fëmijë në situatë rruge.

6. Sfidat e sistemit të drejtësisë në identifikimin, hetimin dhe gjykimin e rasteve të fëmijëve në punë

Mungesa e zbatimit të ligjeve në Kosovë, e njohur si moszbatim i parimit të sundimit të së drejtës, ka lejuar të lulëzojë dhe të përhapet ekonomia në hije dhe korrupcioni që kanë pushtuar shumë aspekte të jetës së njerëzve, e të cilat ndikojnë edhe në shtimin e rasteve të punëve të rënda të fëmijëve. Arsye tjetër është edhe varfëria e skajshme e shumë familjeve kosovare dhe mungesa e efikasitetit në luftimin e kësaj dukurie, duke mos identifikuar rastet e tilla, e nëse edhe verifikohen, ato nuk raportohen në organet e hetuesisë dhe në gjykata.

Në Këshillin Gjyqësor (KGJK) dhe atë Prokurorial të Kosovës (KPK) nuk janë siguruar të dhëna specifike statistikore për Aktakuzat dhe Aktgjykimet, pasi që ato nuk janë të klasifikuara si të tilla për punët e rënda të fëmijëve. Nga të dhënat e dërguara nga KGJK dhe KPK, sipas kërkesës së dërguar me shkrim, rastet e punës së palejuara të fëmijëve nuk mund të identifikohen pasi që nuk figurojnë me emërtime të tilla. Megjithatë pas intervistave me gjykatës dhe prokuror, ata pohojnë se ekzistojnë raste të shumta të punëve të palejuara për fëmijët të cilat trajtohen, por që nga ato vepra kalohet në vepra tjera penale më të rënda, andaj në statistika nuk figuron puna e rëndë apo e palejuar e fëmijëve, por në statistika përshkruhen veprat penale psh. Trafikim ose mundësim i prostitucionit dhe formave tjera të abuzimit dhe keqpërdorimit të fëmijëve, por kjo mund të identifikohet vetëm gjatë leximit dhe analizimit të aktakuzës dhe aktgjykimit për motivet dhe shkaqet e veprës penale dhe rrethanat se si ka ardhë deri tek kryerja e saj. Pra fillimi është puna e rëndë dhe e palejuar e fëmijëve, e pastaj përfundon në vepra të rënda penale.

Koordinimi i pamjaftueshëm dhe mos reagimi institucional në procedimin ligjor të shtytësve dhe shfrytëzuesve të fëmijëve në punë të rënda është evident dhe kjo vazhdon të jetë mangësi e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga punët e rënda. Ekonomia joformale, mbikëqyrja e pamjaftueshme, si dhe mungesa e vetëdijësimit

për raportimin e rasteve të fëmijëve në punë ka ndikim të drejtpërdrejtë në:

- a. shtimin e rasteve të formave të rënda të punës së fëmijëve që kanë lidhje me aktivitetet kriminale (aktivitete të jashtëligjshme, trafikim me qenie njerëzore, prostitucion, abuzim me substanca psiko aktive, etj), dhe
- b. në mos zbatimin e ligjeve dhe politikave të ndërlidhura me punën e fëmijëve.

Kjo flet më së miri për rolin proaktiv që duhet ta kenë institucionet gjegjëse për parandalimin dhe luftimin e punëve të rënda për fëmijët, e me këtë parandalimin e veprave penale dhe viktimizimin e fëmijëve. Rolin kryesor duhet ta kenë mekanizmat e shumtë që janë në kontakt me fëmijët siç janë: institucionet shkollore, shërbimet shëndetësore, shërbimet e sociale, inspektoratet e ndryshme (Inspektorati i punës, Inspektorati sanitar, Inspektorët e bujqësisë dhe pylltarisë, etj).

Nga ana tjetër vlen të theksohet se sistemi prokurorial dhe gjyqësor vazhdon të mos ketë një sistem të integruar të menaxhimit të të dhënave që do të ndihmonte në përgjigjen institucionale ndaj formave të punës së fëmijëve, duke regjistruar rastet e aktakuzave të ngritura për vepra penale dhe aktgjykimeve që u referohen punëve të rënda të fëmijëve.

Vitet e fundit janë bërë përpjekje serioze për avancimin e sistemit për administrimin e rasteve prokuroriale dhe gjyqësore, por nevojitet funksionalizimi i tij dhe ndarja e rasteve me emërtime precize të veprave penale dhe Aktgjykimeve.

Përfundime

Punët e rënda të fëmijëve, si formë e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, përbëjnë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Kosovë, dhe ato zhvillohen në kundërshtim të hapur me legjislacionin në fuqi dhe standartet ndërkombëtare të OKB-së dhe ILO's. Gjendja jo e mirë lidhur me shfrytëzimin ekonomik të fëmijëve në punë të rënda është përkeqësuar edhe për shkak të mungesës së sanksioneve kundërvajtëse dhe penale ndaj të gjithë atyre që shfrytëzojnë fëmijët në punë të rënda.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Neni 32 kërkon që shtetet palë të njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cënon edukimin e tij/saj ose dëmton shëndetin apo zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror. Ky nen rreptësisht ndalon punën e fëmijëve dhe kërkon që Shtetet Palë të përcaktojnë moshën minimale për punësim, të definojnë orët dhe kushtet për punësimin e pranueshëm të të rinjëve dhe të krijojnë mekanizma zbatues me qëllim që të nxiten përputhshmëria nga ana e të gjithë akterëve potencial.

Kosova ka miratuar ligjet e saj vendore të cilat në masë të madhe janë përafuar edhe me detyrimet dhe përkufizimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës - ILO (duke përfshirë format më të rënda të punës, moshën dhe standardet që pengojnë fëmijët që të angazhohen në punë të rrezikshme) pavarësisht faktit se nuk ka ratifikuar Konventën e ILO për Punën e Fëmijëve për shkak të statusit të tanishëm politik ndërkombëtar. Vlenë të theksohet se Kosova ka miratuar Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve 2011 - 2016.

Një ndër shkaqet më të shpeshta të punës së fëmijëve është padyshim varfëria, niveli i kulturës dhe mendësia familjare, si dhe mungesa e cilësisë në arsim (përfshirë barrierat në qasje), gjë që përbëjnë faktor nxitës në punët e rënda të fëmijëve.

Punët më të rënda të fëmijëve që janë prezente në Kosovë janë kërkim lëmosha, puna si kamarieri/kamariet, pastrues të veturave, puna në xehtari (miniera sipërfaqësore), bujqësi, ndërtimtari, prerja e drunjëve, mbledhja e sendeve të ndryshme në mbeturina, detyrimi për të shitur nëpër vende të ndryshme gjësende të ndryshme, përfshirë edhe sende të ndaluara siç është duhani e të ngjashme, pastaj kontrabandimi i kafshëve, si dhe puna në sektorë tjerë të rrezikshëm për shëndetin dhe jetën e fëmijëve, ku shumica e këtyre fëmijëve që angazhohen në këto punë janë nën moshën 14 vjeçare. Shqetësues është fakti se shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve është prezent në masë të madhe edhe në punët e familjes/shtëpiake, gjë e cila përbën problem serioz dhe krijon vështirësi për zbulimin e këtij lloji të abuzimit.

Pasojat e përfshirjes së mijëra fëmijëve në punë të rënda në një moshë tepër të vogël përbjnë problem shumë të madh mbarëshoqëror, pasi që këta fëmijë në të shumtën e rasteve përfundojnë në vepra ndër më të rënda penale, qoftë si kryes qoftë si viktimat.

Niveli i reagimit të institucioneve (por edhe palëve tjera) në identifikimin dhe rritjen e raportimit të rasteve të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve është shumë i vogël. Të dhënat e disponueshme në Qendrat për Punë Sociale dhe në Inspektoratin e Punës për fëmijët e përfshirë në punë të rënda nuk pasqyrojnë realitetin, andaj edhe paraqiten sfida të mëdha për të bërë analizë të drejtë të situatës për qasje adekuate ndaj kësaj dukurie nga dikasteret përkatëse të Qeverisë, si dhe për përgatitjen e politikave të përshtatshme legjislative dhe operacionale për këtë kategori të ndjeshme të fëmijëve.

Nga ana tjetër, Qendrat për Punë Sociale nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbime adekuate dhe cilësore për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare. Në përgjithësi, ka mungesë të shërbimeve, programeve të

rehabilitimit dhe reintegrimit për fëmijët e përfshirë në punë. Përveç QPS, edhe Inspektorati i Punës një agjenci tjetër e ngarkuar me detyrë për të identifikuar rastet e fëmijëve të përfshirë në punë dhe për të reaguar në ato vende të punësimit që mund të jenë në kundërshtim me ligjin, nuk është i pranishëm në të gjitha komunat dhe është i kufizuar në staf dhe kohë.

Për më tepër, fëmijët e përfshirë në punë të rrezikshme nuk janë të vetëdijshëm për mundësinë e vetë-raportimit ose atë të raportimit të bashkëmoshatarëve.

Nisur nga kjo, raportet statistikore që ekzistojnë për punën e fëmijëve duhet të shërbejnë si këmbanë alarmi për masat dhe veprimet që duhet të ndërmerren me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve nga aspekti multidiciplinarë dhe përmes bashkëpunimit ndërsektorial përmes shërbimeve të integruara të mbrojtjes, përfshirë: shërbimet e sektorit të shëndetësisë, arsimit, punës dhe mirëqenies sociale, pastaj sektori i policisë, hetuesisë dhe gjyqësisë, hallka këto të cilat janë të domosdoshme të bashëpunojnë ngusht për të arritur sukses në këtë fushë shumë të rëndësishme për të ardhmen e shoqërisë në përgjithësi.

Rekomandime

Të zhvillohet një analizë e gjerë për identifikimin e arsyeve të mos zbatimit të ligjeve ekzistuese dhe rishikimin e tërësishëm të legjislacionit që prek punën e rëndë të fëmijëve për të parashikuar dhe sanksionuar edhe më ashpër dhe në mënyrë më precize angazhimin e fëmijëve në punë të rënda, si dhe për të ashpërsuar politikën ndëshkimore nga ana organeve të zbatimit të ligjit, përfshirë këtu edhe mos lajmërimin e veprave penale të cilat kanë të bëjnë me punët e rënda të fëmijëve.

Nevojitet me urgjencë që të bëhet monitorimi i punës së fëmijëve, në pajtim me nenin 5 të Konventës së ILO-së nr. 182, për të shërbyer si bazë për formalizimin e procedurave standarde të veprimit për:

- identifikimin, tërheqjen, mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga rruga;
- dokumentimin e trendeve të punës së fëmijëve në sektorë specifikë;
- vlerësimin e efikasitetit të ndërhyrjeve ekzistuese në nivel lokal, duke përfshirë rekomandimet dhe udhëzimet për veprime konkrete dhe hartimin e politikave, strategjive dhe planeve konkrete të veprimit dhe referimin e rasteve në Prokurori dhe Gjykata.

Organet e zbatimit të ligjit në përgjithësi përfshirë: inspektoratin, policinë, prokurorinë dhe gjykatat, duhet t'i referojnë dhe t'u japin prioritet zhvillimit të procedurave për të gjitha rastet e punëve të rënda të fëmijëve, pasi që zvarritja e procedurave ndikon negativisht në sigurimin e provave; kjo për faktin se fëmijët kanë mundësi të ndryshojnë deklaratat e tyre dhe prindi që abuzon me fëmijën apo punëdhënësit e ndryshëm do të amnistohen për shkak të parashkrimit apo për shkak të deklaratave të fëmijës në favorin e tyre për qëllime të ndryshme. Aq më tepër kjo situatë vështirësohet kur prindi është i akuzuar ndërsa fëmija është viktimë, pasi që fëmija dëshmon në favor të prindit.

Në të gjitha procedurat, qoftë administrative apo gjyqësore, duhet t'i kushtohet kujdes mbrojtjes së fëmijëve qofshin ata në kontakt apo në konflikt me ligjin (viktima të veprave penale, dëshmitarë, kryes të veprave penale). Mos raportimi i rasteve të punëve të rënda të fëmijëve duhet të sanksionohet konform dispozitave të Kodit Penal ku përcaktohet se nëse gjatë kryerjes së detyrës zyrtare mësohet se dikush ka kryer veprë penale dhe një rast i tillë nuk raportohet, personi zyrtarë përgjigjet për veprën penale të mos raportimit. Andaj zbatimi i kësaj dispozite penale do të ndikojë në zbatimin e ligjeve respektive dhe mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda.

Nevojitet të bëhen edhe analiza të mirëfillta të recidivizmit të punëve të rënda të fëmijëve, sidomos lëmshëkërkuesve, si dhe të shtohet buxheti për përkrahjen e familjeve dhe parandalimin e punëve të rënda të fëmijëve për shkak të varfërisë së skajshme. Analizat do t'i ndihmonin sistemi i integruar i menaxhimit të informacioneve për rastet e punës së rëndë të fëmijëve.

Rritja e numrit të inspektorëve dhe shtimi i përpjekjeve për identifikimin dhe referimin e rasteve të punëve të rënda të fëmijëve jo vetëm për kundërvajtje, por të inicohet edhe procedurë penale në momentin që identifikohen fëmijët duke punuar punë të rënda që nuk janë në përputhje me moshën e tyre.

Duhet të punohet shumë edhe në parandalimin e punës së fëmijëve; fillimisht përmes trajnimeve të vazhdueshme nëpër regjione me këshillat e prindërve të shkollave, trajnime me gjyqtar, prokurorë, policë, inspektorë (Inspektorët e punës, ata të bujqësisë, pylltarisë, etj), avokat, zyrtarë të Qendrave për Punë Sociale dhe të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në funksion të parandalimit do të ishte edhe ngritja e qasjes në arsim përmes sigurimit të kushteve buxhetore dhe infrastrukture, si dhe sanksionimi i të gjitha

rasteve ndaj prindërve për shkak të braktisjes së shkollës nga fëmijët e tyre. Gjithashtu edhe kurikulat shkollore duhet t'i kushtojnë rëndësi më të madhe vetëdijësimit të fëmijëve për të drejtat e tyre dhe detyrimin e prindit apo kujdestarit dhe shtetit për të siguruar mirëqenien dhe mirërritjen e fëmijës, edukimin dhe shkollimin, si dhe mbajtjen me plotësimin e të gjitha kushteve për jetë normale.

Sensibilizimi i të gjithëve për detyrimin ligjor dhe qytetarë për lajmërimin e punëve të rënda të fëmijëve, si dhe ndëshkimi i të gjithë atyre që nuk lajmërojnë rastet e tilla edhe pse këtë e kanë obligim ligjor. Vëmendje e vecantë duhet kushtuar vetëdijësimit të institucioneve shkollore, shëndetësore, inspektorateve, si dhe institucioneve tjera që kanë kontakt me fëmijët që të referojnë rastet në momentin që mësojnë se një fëmijë është abuzuar në të gjitha format, përfshirë edhe format e rënda të punës së fëmijëve, si dhe sensibilizimi i tyre se mos lajmërimi i veprave të tilla penale gjatë kryerjes së detyrës të tyre zyrtare dhe mos referimi në organet kompetente të hetuesisë përbën vepër penale për ta.

Me qëllim të sensibilizimit të opinionit duhet të bëhen edhe kampanja televizive për njoftimin e opinionit publik edhe për pasojat juridike dhe ndëshkimet që pësojnë të gjithë ata që veprojnë në kundërshtim me të drejtat dhe interesat e fëmijëve, deri te heqja e të drejtës prindore dhe ndjekja penale.

